



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1026/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës, Lazër Nrecaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Komunën e Gjakovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.1026/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës, Lazër Nrecaj, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Gjakovë, kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në Qendrën e Votimit 0210C/02R.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 04.11.2021 nga anëtari për Kuvend Komunal në Komunën e Gjakovës, Lazër Nrecaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Komunën e Gjakovës, me të cilën pretendon se në Vendvotimin 0210C/02R, pretendon se ka pasur një votë, ndërsa në Rezultatit Përfundimtar rezultojnë që nuk e ka asnjë votë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelin, vlerësoi se:

#### **Apeli është i pabazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Lazër Nrecaj, anëtari për Kuvend Komunal në Komunën e Gjakovës, Lazër Nrecaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Gjakovë, me të cilën pretendon se nuk e ka asnjë votë në Vendvotimin 0210C/02R, është i pa bazuar. Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tijë, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse apo deklarate të votueses lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluarit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte

konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, i njëjti më tepër mbështetet në deklaratimet e vet apelueses, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**Anr.1026/2021 më datë 07.11.2021**



**Kryesuesi i Panelit**

**Zynda Haxhiri**

***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*